



**INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A.**

*(Ish Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.a.)*

Pasqyrat financiare të konsoliduara për periudhen  
deri më 31 Dhjetor 2008

(me raportin e auditorëve të pavarur)

---

# Permbajtja

---

	Faqe
Raporti i auditoreve te pavarur	1
Bilanci i konsoliduar kontabel	2
Pasqyra e konsoliduar e te ardhurave	3
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital	4 - 5
Pasqyra e konsoliduar e fluksit te mjeteve monetare	6 - 7
Shenime shoqeruese mbi Pasqyrat Financiare	
1. Subjekti Raportues	8
2. Bazat e pergatitjes	9
3. Permbledhje e politikave kontabel	10-30
4. Menaxhimi i riskut financiar	31-48
5. Perdorimi i cmuarjeve dhe gjykimeve	49
6. Veprimtarite e Bankes ne deget e Shqiperise dhe Greqise	50-53
7. Aktivet dhe detyrimet financiare	54-55
8. Informacioni krahasues dhe bashkimi me perthithje me Banken Italo - Albanese	56
9. Mjete monetare dhe te ngjashme	57
10. Hua dhe paradhenie bankave	57
11. Letra me vlere te vendosjes	57
12. Letra me vlere te investimit	58
13. Hua dhe paradhenie klienteve	58-59
14. Ndertesa dhe pajisje	60-61
15. Mjete te qendrueshme te patrupezuara	62
16. Mjete te tjera	63
17. Detyrime ndaj bankave	64
18. Detyrime ndaj klienteve	65-66
19. Borxhi i varur	66
20. Tatimi i shtyre	67
21. Detyrime te tjera	67
22. Kapitali aksioner dhe primet	68
23. Rezerva ligjore dhe rregullative	69
24. Diferenca te tjera rivleresimi	69
25. Te ardhura nga interesi, neto	69
26. Te ardhura nga komisioni, neto	70
27. Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto	70
28. Te ardhura / (shpenzime) te tjera operative, neto	71
29. Shpenzime personeli	71
30. Shpenzime te tjera	71
31. Shpenzime tatimi mbi fitimin	72-73
32. Angazhime dhe te drejta / detyrime rastesore	74
33. Palet e lidhura	75
34. Angazhime qeraje dhe shpenzime qiraje operationale	76
35. Shpjegim lidhur me kalimin ne raportimin sipas SNRF	76-81
36. Ngjarje pas dates se bilancit	81

## **RAPORTI I AUDITOREVE TE PAVARUR PER AKSIONERET E BANKES INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur te Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a. ("Banka"), te cilat permbajne bilancin kontabel me date 31 Dhjetor 2008, dhe pasqyren e te ardhurave, pasqyren e ndryshimeve te kapitalit, dhe pasqyren e fluksit te parase per ushtrimin e mbyllur ne kete date, dhe nje permbledhje te politikave te rendesishme kontabel si dhe shenime te tjera sqaruese.

### **Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e singerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF). Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit te brendshem, i cili eshte i rendesishem per pergatitjen dhe paraqitjen e singerte te pasqyrave financiare pa anomali materiale, qe mund te jene pasoje e mashtrimit apo e gabimeve; perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabel te duhura; dhe berjen e vleresimeve kontabel te cilat jane te arsyeshme per rrethanat.

### **Pergjegjesia e Auditoreve**

Pergjegjesia jone eshte qe, duke u bazuar ne auditimin tone, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe ne tu permbahemi kerkesave etike te pershtatshme, dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te fituar siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidence qe mbeshtet tepricat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura jane ne varesi te gjykimit tone, perfshire ketu vleresimin e rrezeqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Ne kryerjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, ne shqyrtojme kontrollin e brendshem, i cili eshte i rendesishem per pergatitjen dhe paraqitjen e singerte te pasqyrave financiare, me qellim hartimin e procedurave te auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por qe nuk kane per qellim shprehjen e nje opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e pershtatshmerise se parimeve kontabel te perdorura dhe te cmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit jep nje baze te mjaftueshme dhe te pershtatshme per opinionin tone.

### **Opinionit**

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete dhe te drejte per gjendjen financiare te Intesa Sanpaolo Bank Albania me date 31 Dhjetor 2008, dhe per ecurine financiare te saj, dhe flukset e parase per ushtrimin e mbyllur, ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

Ernst & Young Eksperte Kontabel te Autorizuar Shkup, Dega Tirane



# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

Bilanci i konsoliduar kontabel me 31 Dhjetor 2008

(ne '000 Lek)

	Shenime	2008	2007
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe te ngjashme	9	4,497,583	4,847,434
Hua dhe paradhenie bankave	10	8,215,701	5,818,189
Letra me vlere te vendosjes	11	1,963,807	2,594,401
Letra me vlere te investimit	12	46,065,994	32,408,727
Hua dhe paradhenie klienteve	13	43,415,104	30,571,406
Ndertesa dhe pajisje	14	2,027,981	924,056
Mjete te qendrueshme te patrupezuara	15	195,921	116,263
Te drejta tatimore te shtyra	20	39,394	39,343
Te drejta tatimore korrente	31	150,866	-
Mjete te tjera	16	553,262	577,103
<b>Aktive gjithsej</b>		<b>107,125,613</b>	<b>77,896,922</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime ndaj bankave	17	6,489,442	4,079,996
Detyrime ndaj klienteve	18	90,399,380	68,815,984
Llogari rrjedhese		24,216,368	13,931,373
Depozita me afat		66,183,012	54,884,611
Borxhi i varur	19	481,811	428,791
Detyrime tatimore korrente	31	249,000	43,965
Detyrime tatimore te shtyra	20	14,889	20,303
Detyrime te tjera	21	462,897	201,603
<b>Detyrime gjithsej</b>		<b>98,097,419</b>	<b>73,590,642</b>
<b>KAPITALI AKSIONER</b>			
Kapitali i nenshkruar i paguar	22	5,562,518	3,001,851
Primet e aksioneve	22	1,383,880	-
Rezerva ligjore dhe rregullative	23	1,258,387	617,281
Rezerva per letrat me vlere te vendosjes		(1,285,725)	(490,502)
Diferenca e rivleresimit nga kurset e kembimit		6,389	28,416
Diferenca te tjera rivleresimi	24	714,555	416,889
Fitimi i pashperndare		1,388,190	732,345
<b>Totali i Kapitalit Aksioner</b>		<b>9,028,194</b>	<b>4,306,280</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksioner</b>		<b>107,125,613</b>	<b>77,896,922</b>

Shenimet nga faqa 8 deri ne 81 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Stefano Farabbi  
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

Adela Xhemali  
Drejtoresh e Kontrollit Financiar

## Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e te ardhurave deri me 31 Dhjetor 2008

(ne '000 Lek)

	Shenime	2008	2007
Te ardhura nga interesi		7,765,638	5,429,510
Shpenzime interesi		(3,562,523)	(2,733,615)
<b>Te ardhura nga interesi, neto</b>	25	<b>4,203,115</b>	<b>2,695,895</b>
Te ardhura nga komisionet		744,030	510,574
Shpenzime per komisionet		(139,136)	(114,863)
<b>Te ardhura nga komisionet, neto</b>	26	<b>604,894</b>	<b>395,711</b>
Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto	27	312,055	39,962
Te ardhura / (shpenzime) te tjera operacionale, neto	28	15,926	29,172
<b>Te ardhura operative</b>		<b>5,135,990</b>	<b>3,160,740</b>
Humbje nga zhvleresimi i mjeteve financiare, neto	13	(437,232)	(55,511)
Shpenzime personeli	29	(924,238)	(704,626)
Shpenzime qeraje operacionale	34	(211,678)	(240,462)
Zhvleresimi dhe amortizimi	14,15	(356,103)	(233,211)
Amortizimi i permiresimeve te ambienteve me qira	16	(154,034)	(44,655)
Shpenzime te tjera	30	(907,831)	(612,696)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(2,991,116)</b>	<b>(1,891,161)</b>
<b>Fitimi neto para tatimit</b>		<b>2,144,874</b>	<b>1,269,579</b>
Tatimi mbi fitimin	31	(369,096)	(369,114)
<b>Fitimi per periudhen</b>		<b>1,775,778</b>	<b>900,465</b>

Shenimet nga faqa 8 deri ne 81 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Stefano Farabbi  
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

Adela Xhemali  
Drejtoresh e Kontrollit Financiar

## Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital deri me 31 Dhjetor 2008

( ne '000 Lek)

	Kapitali i paguar	Primet e aksioneve	Rezervat		Rezervat e vleresimit			Fitimi i vitit	Totali
			Fitimi i pashperndare	Rezerva statutore, te pergjithshme dhe ligjore	Rezerva per letrat me vlere te vendosjes	Rezerve e rivleresimit nga kurset e kembimit	Diferenca te tjera rivleresimi		
<b>Gjendja me 1 Janar 2007</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	<b>3,418,740</b>	-	<b>68,634</b>	<b>380,527</b>	<b>(351,787)</b>	<b>15,269</b>	-	-	<b>3,531,383</b>
Kalimi i fitimit te mbartur	-	-	(236,754)	236,754	-	-	-	-	-
Ndryshimi ne vleren e investimit ne letra me vlere te vendosjes, neto					(138,715)				(138,715)
Diferenca valutore e rivleresimit	-	-	-			13,147	-	-	13,147
Rivleresimi ne vite i kapitalit	(416,889)	-	-	-	-	-	416,889	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-	900,465	900,465
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2007</b>	<b>3,001,851</b>	-	<b>(168,120)</b>	<b>617,281</b>	<b>(490,502)</b>	<b>28,416</b>	<b>416,889</b>	<b>900,465</b>	<b>4,306,280</b>

## Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital deri me 31 Dhjetor 2008

( ne '000 Lek)

	Kapitali i paguar	Primet e aksioneve	Rezervat		Rezervat e vleresimit			Fitimi i vitit	Totali
			Fitimi i mbartur	Rezerva statutore, te pergjithshme dhe ligjore	Rezerva per letrat me vlere te vendosjes	Rezerve e rivleresimit nga kurset e kembimit	Diferenca te tjera rivleresimi		
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2007</b>	<b>3,001,851</b>	-	<b>(168,120)</b>	<b>617,281</b>	<b>(490,502)</b>	<b>28,416</b>	<b>416,889</b>	<b>900,465</b>	<b>4,306,280</b>
Efekti i bashkimit	1,307,824	-	(315,485)	614,140	-	-	297,666	-	1,904,145
<b>Gjendja pas bashkimit me 1 Janar 2008</b>	<b>4,309,675</b>	-	<b>(483,605)</b>	<b>1,231,421</b>	<b>(490,502)</b>	<b>28,416</b>	<b>714,555</b>	<b>900,465</b>	<b>6,210,425</b>
Zmadhimi i kapitalit aksioner	446,250	1,383,880	-	-	-	-	-	-	1,830,130
Kalimi i fitimit te mbartur	806,593	-	(833,559)	26,966	-	-	-	-	-
Ndryshimi ne vleren e tregut ne letra me vlere te vendosjes, neto,	-	-	-	-	(795,223)	-	-	-	(795,223)
Diferenca valutore e rivleresimit	-	-	29,111	-	-	(22,027)	-	-	7,084
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-	1,775,778	1,775,778
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2008</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>(1,288,053)</b>	<b>1,258,387</b>	<b>(1,285,725)</b>	<b>6,389</b>	<b>714,555</b>	<b>2,676,243</b>	<b>9,028,194</b>

Shenimet nga faqa 8 deri ne 81 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Stefano Farabbi  
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

Adela Xhemali  
Drejtoresh e Kontrollit Financiar

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fluksit te mjeteve monetare deri me 31 Dhjetor 2008

(ne '000 Lek)

	2008	2007
<b>Fluksi i parase nga/(ne) aktivitetet operative</b>		
Fitimi neto	<b>1,775,778</b>	<b>900,465</b>
Zerat qe rakordojne fitimin para tatimit me mjetet monetare neto te perdorura ne aktivitetet operacionale		
Zhvleresimi i ndertesave dhe pajisjeve	253,801	125,366
Amortizimi i mjeteve te qendrueshme te patrupezuara	68,729	55,906
Zhvleresimi i permiresimeve te ambjenteve me qira	154,034	44,655
Shitja e mjeteve te qendrueshme te patrupezuara	-	127
Shitja e ndertesave dhe pajisjeve	21,564	2,126
Amortizimi i investimeve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim- bono thesari	(336,522)	57,228
Amortizimi i investimeve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim- te ndryshme nga bono thesari	(436,199)	(1,054)
Amortizimi i letrave me vlere te vendosjes	(9,342)	(7,799)
Humbje nga mjetet financiare	437,232	55,511
Pakesimi (rritje) ne interesin per t'u arketuar	(7,319)	(51,314)
Rritje(pakesim) ne interesin per t'u paguar	313,198	353,612
Diferenca nga ndryshimi i kursit te kembimit	(38,947)	15,856
<b>Ndryshime ne aktive dhe detyrime operative</b>		
Ndryshimi ne tregtimin e letrave me vlere te vendosjes	-	2,784,662
Ndryshime ne hua dhe paradhenie bankave	4,282,335	11,248,269
Ndryshime ne hua dhe paradhenie klienteve	(4,990,733)	(5,578,918)
Ndryshime ne aktive te tjera	(24,727)	10,661
Ndryshime ne aktive tatimore te shtyra	(976)	94,573
Ndryshime ne detyrime ndaj bankave	2,212,009	(15,789,707)
Ndryshime ne detyrime ndaj klienteve	(3,297,301)	13,050,531
Ndryshime ne detyrime te tjera	(40,014)	39,574
Ndryshime ne detyrime tatimore te shtyra	(6,339)	4,305
Ndryshime ne tatime korente	54,168	(270,237)
<b>Fluksi neto i parase nga aktivitetet operative</b>	<b>(1,391,349)</b>	<b>6,243,933</b>
<b>Fluksi i parase nga aktivitetet investuese</b>		
Shitja (blerja) e mjeteve te qendrueshme te patrupezuara	(141,257)	(48,008)
Shitja (blerja) e ndertesave dhe pajisjeve	(841,262)	(399,426)
Shitja e letra me vlere per tu shitur	(155,286)	(199,518)
Shitja e letra me vlere te mbajtura deri ne maturim	(4,594,584)	(4,122,682)
<b>Fluksi neto i parase nga aktivitetet investuese</b>	<b>(5,732,389)</b>	<b>(4,769,634)</b>



## Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fluksit te mjeteve monetare deri me 31 Dhjetor 2008

(ne '000 Lek)

	2008	2007
<b>Rrjedhja neto e parase nga aktivitetet investuese</b>		
Zmadhimi (zvogelimi) i borxhit te varur	(417,310)	(58,314)
Emetim i kapitalit aksioner	1,830,130	
<b>Fluksi neto i parase nga aktivitetet e financimit</b>	<b>1,412,820</b>	<b>(58,314)</b>
<b>Ndryshimi i mjeteve monetare gjate periudhes</b>	<b>(3,935,140)</b>	<b>2,316,450</b>
Mjete monetare e te ngjashme ne fillim te periudhes	4,847,434	2,530,984
Efekti i bashkimit (shenimi 8)	3,585,289	
<b>Mjete monetare e te ngjashme ne fund te periudhes</b>	<b>4,497,583</b>	<b>4,847,434</b>
<b>Fluksi i parase nga interesat:</b>		
Interesa te paguara	3,249,325	2,380,003
Interesa te arketuara	7,758,319	5,378,196

Gjate vitit 2008 Banka pagoi si Tatim Fitimi, per vitin aktual si dhe per vitet e meparshme, nje shume totale prej Lek 294,519 mije (2007: Lek 248,000 mije).

Shenimet nga faqa 8 deri ne 81 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga Keshilli Drejtues i Bankes ne 6 Prill 2009. Pas nxjerrjes se tyre, çdo ndryshim eshte kompetence e Aksionereve te Bankes. Pasqyrat financiare jane firmosur ne emer te Bankes nga:

\_\_\_\_\_  
Stefano Farabbi  
Drejtore i Pergjithshem Ekzekutiv

\_\_\_\_\_  
Adela Xhemali  
Drejtore e Kontrollit Financiar

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 1. Subjekti raportues

Intesa Sanpaolo Bank Albania, (me poshte referuar “Banka”), eshte themeluar ne Maj te vitit 1998 me zyrtat e saj qendrore ne Tirane, ne adresen Rr. Ismail Qemali, nr. 27. Banka u autorizua qe te ushtronte aktivitet bankar ne Shqiperi ne perputhje me Ligjin nr. 8365, “Per Sistemin Bankar ne Shqiperi”, qe daton ne 2 Korrik 1998, i cili u zevendesua nga Ligji nr. 9662 “Per Bankat ne Shqiperi”, date 18 Dhjetor 2006, i cili hyri ne fuqi ne Qershor 2007. Banka e filloi aktivitetin e vet me 24 Shtator 1998.

Me 20-21 Dhjetor 2006, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve (me poshte referuar “FSHAN”) ne cilesine e tij si aksioneri i vetem i Bankes, firmosi nje marreveshje per Shitblerjen e Aksioneve (me poshte referuar “Marreveshja e Blerjes”) me SANPAOLO IMI s.p.a (“Bleresi”), nje kompani e themeluar ne perputhje me Ligjet e Republikes Italiane, me synimin e shitjes te 12,000,000 aksioneve te Bankes me nje vlere nominale prej 2.2266 USD qe perbente rreth 80% te vleres totale te kapitalit te Bankes, kundrejt nje çmimi prej 125,520 mije USD (“Çmimi i Blerjes”). Me 1 Janar 2007, SANPAOLO IMI s.p.a dhe Banca Intesa S.p.a krijuan Intesa Sanpaolo S.p.a nepermjet bashkimit te te dy bankave. Ne 29 Qershor 2007, Data e Mbylljes e percaktuar ne Marreveshjen e Blerjes, pas plotesimit te te gjitha kushteve, perfaqesuesit e FSHAN dhe te Intesa Sanpaolo s.p.a nenshkruan transferimin e aksioneve.

Banka dhe Banka Italo Albanese Sh.a. (e njohur si Banka Italo Shqiptare ose BIA) u bashkuan nepermjet perthithjes se aktiveve dhe pasiveve te BIA ne aktivitetet e Intesa Sanpaolo Bank Albania. Perpara bashkimit aksioneret e Intesa Sanpaolo Bank Albania ishin Intesa Sanpaolo S.p.a dhe FSHAN duke zoteruar perkatesisht 80% dhe 20% te kapitalit aksioner. Aksioneret e BIA ishin Intesa Sanpaolo S.p.a, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (me poshte referuar BERZH) dhe Societa Italiana per le Imprese all’ Estero S.p.A (me poshte referuar “SIMEST”) duke zoteruar perkatesisht 76.129%, 20% dhe 3.871% te kapitalit aksioner te BIA. Raporti i kembimit te aksioneve u vendos nepermjet metodologjise se percaktimit te vleres kontabel (percaktimi i vleres se aktiveve, neto). Raporti i kembimit te aksioneve u percaktua ne baze te numrit te aksioneve te secilit aksioner nisur nga vleresimi i pozicionit financiar te seciles Banke me 30 Qershor 2007 si nje perqindje e kombinimit te vleresimit te te dyja bankave ne te njejten date, pavaresisht nga numri i aksioneve qe do te regjistroheshin. Aksioneret e Bankes dhe BIA miratuan termat dhe kushtet e bashkimit sikunder ishin parashikuar ne Planin e Bashkimit dhe ne Marreveshjen per Bashkimin e Bankave, date 6 Nentor 2007, si dhe ne shtojcen e saj, date 4 Dhjetor 2007.

Si rrjedhoje e bashkimit te Bankave si dhe e zgjerimit te metejshe te aktiviteteteve bankare, numri i degeve dhe agjensive te rrjetit bankar arriti ne 37, te shtrira ne qytete te ndryshme te Shqiperise: Tirane, Durres, Vlore, Elbasan, Fier, Gjirokastr, Korçe, Lushnje, etj, si dhe ne Greqi me kater dege ne Athine, Selanik, Peristeri dhe Pire. (ne 2007: Banka kishte 27 dege, ish BIA 7 dege).

Ne 31 Dhjetor 2008 Banka numeronte 511 punonjes (ne 2007: 400). Krijta e numrit te punonjesve ishte kryesisht rezultat i bashkimit me BIA-n, e cila ne 31 Dhjetor 2007 numeronte 101 punonjes.

Pas marrjes se miratimit perfundimtar te Bankes se Shqiperise, date 13 Tetor 2008, emri i Bankes u ndryshua nga Banka Amerikane e Shqiperise ne Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Pasqyrat financiare te konsoliduara te Bankes deri me 31 Dhjetor 2008 dhe per periudhen ushtrimore te mbyllur, perfshijne gjithashtu filialin ne Greqi (deget ne Greqi), i cili operon si subjekt ligjor me vete.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **2. Bazat e Pergatitjes**

#### **(a) Deklarate per perputhshmerine rregullative**

Pasqyrat financiare te konsoliduara jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te miratuara nga Keshilli per Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit (IASB). Duke filluar nga data 1 Janar 2008, zbatimi i SNRF eshte nje kerkese statutore per te gjitha institucionet financiare qe operojne ne Shqiperi. Per Banken eshte hera e pare e aplikimit te SNRF. Ne shenimin 35 shpjegohet se si kalimi ne raportimin sipas SNRF ka ndikuar ne pozicionin financiar qe eshte raportuar me hapjen e bilancit kontabel ne 1 Janar 2007, si dhe ne ecurine financiare te Bankes per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2007.

#### **(b) Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare te konsoliduara jane pergatitur ne perputhje me parimin e kostos historike, duke bere perjashtim vetem per mjetet financiare te letrave me vlere te vendosjes, te cilat jane te matura me vleren reale.

#### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare te konsoliduara jane te raportuara ne Lek, e cila eshte ne te njejten kohe edhe monedha funksionale e Bankes.

Ndryshimet e rivleresimit perfshijne te gjitha diferencat nga kurset e kembimit si pasoje e konvertimit te pasqyrave financiare te veprimtarise se filialit te huaj ne monedhen funksionale dhe raportuese te Bankes. Monedha funksionale e degeve te Greqise eshte Euro.

Me perjashtim te rasteve kur eshte specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur ne Lek eshte rrumbullakosur ne te mijten me te afert.

#### **(d) Perdorimi i cmuarjeve dhe gjykimeve**

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe drejtimi te jape gjykimet, perlllogaritjet, çmuarjet dhe presupozimet qe prekin zbatimin e politikave kontabel dhe shumen e raportuar te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto perlllogaritje.

Perlllogaritjet dhe supozimet e ndryshme rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e perlllogaritjeve kontabel njihen per periudhen kur behet rishikimi i perlllogaritjes dhe ne çdo kohe ne te ardhmen qe preket si rrjedhoje e kesaj te fundit.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel

Politikat kontabel qe vijojne me poshte jane zbatuar ne menyre te vazhdueshme gjate gjithë periudhes se ketyre pasqyrave financiare dhe jane aplikuar vazhdimisht nga subjektet e Bankes.

#### (a) Bazat e konsolidimit

##### (i) Filialet

Filialet jane entitete te cilat jane te kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka te drejta per te qeverisur politikat financiare dhe operative te nje entiteti ne menyre qe te perfitoje te mira prej ushtrimit te aktivitetit te tij. Gjate vleresimit te kontrollit, te drejtat e votes qe ushtrohen aktualisht, jane marre ne konsiderate. Pasqyrat financiare te filialeve jane te perfshira ne pasqyrat financiare te konsoliduara qe nga data e fillimit te ushtrimit te kontrollit deri ne daten qe ky kontroll merr fund.

##### (ii) Transaksionet e eliminuara gjate konsolidimit

Tepricat qe rrjedhin nga marredhenie brenda grupit, dhe te ardhurat e shpenzimet e perealizuara qe burojne nga transaksione brenda grupit, jane eliminuar ne momentin qe jane pergatitur pasqyrat financiare te konsoliduara. Te ardhurat e perealizuara jane eliminuar ne pergatitjen e pasqyrave financiare te konsoliduara. Shpenzimet e perealizuara jane eliminuar ne te njejten menyre si te ardhurat e perealizuara, por vetem ne ate mase kur nuk ka tregues per zhvleresim.

##### (iii) Bashkimi me entitete nen te njejtin kontroll

Bashkimi me perthithje i Bankes me BIA u kontabilizua me 1 Janar 2008, sipas percaktimit ne marreveshjen e bashkimit. Te dy entitetet ishin nen kontrollin e perbashket te Intesa Sanpaolo, si pasoje krahasuesit e pasqyrave financiare nuk jane rishikuar. Nje informacion me i detajuar eshte paraqitur ne shenimin 8 te ketyre pasqyrave financiare.

Mjetet dhe detyrimet e marra jane njohur ne vleren e tyre kontabel, te njohur me pare ne pasqyrat financiare te konsoliduara te grupit te aksionereve nen kontrollin e tyre.

#### (b) Monedha e huaj

##### (i) Konvertimi i monedhave te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale te Bankes me kursin e kembimit te dates se transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare ne valute te huaj jane ri-konvertuar ne monedhen funksionale me kurset e kembimit ne daten e mbylljes se bilancit. Te gjitha diferencat respektive si pasoje e kesaj te fundit, kalojne ne pasqyren e te ardhurave, pervec diferencave qe vijne nga rivleresimi i kapitalit te nenshkruar te paguar, te cilat transferohen menjehere ne nje rezerve te posaçme te kapitalit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne valute te huaj te matura me vleren reale, jane ri-konvertuar me kursin e kembimit te dates se percaktimit te vleres reale. Ndryshimet valutore te cilat rezultojne nga ri-konvertimet njihen ne llogarine fitim humbje.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(b) Monedha e huaj (vazhdim)**

##### **(ii) Operacionet e huaja**

Mjetet dhe detyrimet nga operacionet e huaja jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Te ardhurat e shpenzimet nga operacionet e huaja jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Diferencat valutore njihen direkt ne kapital. Nga data 1 Janar 2007, data e kalimit te raportimit te Bankes sipas SNRF, keto diferenca jane pasqyruar ne rezerven per diferencen valutore te rivleresimit. Kur nje operacion i huaj mbyllet pjeserisht ose plotesisht, shuma perkatese e diferences valutore te rivleresimit transferohet ne llogarine fitim humbje.

#### **(c) Interesat**

Te ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen ne pasqyren e te ardhurave me ane te metodes se normes efektive te interesit. Norma efektive e interesit eshte norma e cila ben zbritjen e pagesave dhe arketimeve te pritshme ne te ardhmen gjate kohezgjatjes se pritshme te aktivitetit ose detyrimit financiar (ose mund te jete nje periudhe me e shkurter) nga shuma e mbartur e aktivitetit dhe detyrimit financiar. Norma efektive e interesit percaktohet me njohjen fillestare te aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet me pas.

Llogaritja e normes efektive te interesit perfshin te gjitha komisionet e paguara ose te arketuara, shpenzimet per transaksionet, dhe zbritjet ose primet qe jane pjese e normes efektive te interesit. Shpenzimet e transaksionit jane shpenzime shtese qe i atribuohen ne menyre direkte blerjes, emetimit ose shitjes se nje aktiviteti ose detyrimi financiar.

#### **(d) Komisionet**

Te ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet qe jane pjese integrale e normes efektive te interesit te nje aktiviteti ose detyrimi financiar perfshihen ne percaktimin e normes efektive te interesit.

Te ardhurat e tjera nga komisionet, perfshire komisionet e sherbimit, komisionet per menaxhim investimi, komisionet per shitje dhe vendosje depozite njihen ne momentin e kryerjes se sherbimit. Shpenzime te tjera nga komisionet lidhen kryesisht me komisionet per transaksione dhe sherbime, te cilat kalojne ne shpenzime ne momentin e marrjes se sherbimit te ofruar.

#### **(e) Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto**

Keto te ardhura perfshijne fitimin pa humbjet qe rezultojne nga tregtimi i aktiveve dhe detyrimeve, dhe perfshijne te gjitha ndryshimet e vleres reale dhe diferencat e kembimeve valutore.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(f) Dividentet**

Te ardhurat nga dividentet njihen kur vendoset e drejta per te perfituar te ardhura. Zakonisht, kjo behet ne daten e ish-dividentit per letrat me vlere te kapitalit. Dividentet pasqyrohen si komponent i te ardhurave bankare neto nga tregtueshmeria, te ardhurave neto nga instrumente te tjera financiare me vlere reale ose te ardhurave te tjera operative te cilat bazohen ne klasifikimin e instrumentit te kapitalit.

#### **(g) Qiraja dhe permiresimet e ambjenteve me qera**

Percaktimi nese nje marreveshje eshte kontrate qiraje ose permban nje te tille, bazohet ne thelbin dhe permbajtjen e marreveshjes e cila duhet te vleresohet nese permbushja e detyrimeve te marreveshjes varet nga perdorimi i nje aktivi ose aktiveve te vecante dhe ne marreveshje parashikohet e drejta per perdorimin e aktivitetit.

Banka ka vetem marreveshje qiraje operationale, pagesat e te cilave njihen ne pasqyren e te ardhura me metoden lineare gjate gjithë kohezgjatjes se qirase. Shpenzimet per permiresimin e ambjenteve qe perdoren ne baze te ketyre marreveshjeve kontabilizohen si mjete te tjera dhe amortizimet gjate kohezgjatjes se afatit te qirase.

Pagesat rastesore per qirate kontabilizohen me ane te rishikimit te pagesave minimale te qirase per periudhen e mbetur te qirase ne momentin e konfirmimit te ndryshimit te kontrates se qirase.

#### **(h) Tatimi mbi fitimin**

Te drejtat apo detyrimet aktuale tatimore per vitin korent dhe ato te meparshme llogariten ne ate vlere qe pritet per t'u mbuluar nga ose paguar te autoritetet tatimore. Normat e taksave dhe ligjet ne lidhje me to te perdorura per llogaritjen e vleres se detyrimit tatimor jane ato qe ndodhen ne fuqi apo qe jane pothuajse fuqizuar ne daten e bilancit.

Tatimi i shtyre gjendet mbi diferencat e perkohshme ne daten e bilancit ndermjet bazes se taksueshme te mjeteve dhe detyrimeve dhe vlerave te tyre te mbartura per qellime raportimesh financiare. Detyrimet te shtyra tatimore njihen per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme, pervec:

- ku detyrimi i shtyre tatimor vjen si pasoje e njohjes fillestare te nje te drejte apo detyrimi ne nje transakcion qe nuk eshte kombinim biznesi, dhe ne momentin e transakcionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel as ne fitimin apo humbjen e taksueshme; dhe
- ne lidhje me diferencat e perkohshme te taksueshme te lidhura me investimet ne filialet, ku koha e rikthimit te diferencave te perkohshme mund te kontrollohet dhe eshte e mundshme qe diferencat e perkohshme te mos kthehen ne nje te ardhme te parashikueshme (te afert).

E drejta tatimore e shtyre njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te zbritshme, deri ne ate nivel ku eshte e mundshme qe fitimi i tatueshem te materializohet kundrejt te cilit diferencat e perkohshme te zbritshme mund te perdoren, pervec:

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (h) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

- ku te drejtat tatimore te shtyra te lidhura me diferencat e perkohshme te zbritshme vijne si pasoje e njohjes fillestare te nje njeti apo detyrimi ne nje transakcion qe nuk eshte kombinim biznesi, dhe qe ne momentin e transakcionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel as ne fitimin apo humbjen e tatueshme; dhe
- ne lidhje me diferencat e perkohshme te zbritshme qe i atribuohen investimeve ne filiale, te drejtat e shtyra tatimore jane njohur deri ne ate nivel ku eshte e mundshme qe diferencat e perkohshme do te kthehen ne nje te ardhme te afert dhe fitimi i tatueshem do te jete materializuar kundrejt te cilit diferencat e perkohshme mund te perdoren.

Vlera e mbartur e te drejtave tatimore te shtyra rishikohet ne çdo date bilanci dhe reduktohet deri ne ate nivel qe nuk eshte me e mundshme qe nje fitim i mjaftueshem dhe i tatueshem do te materializohet per te lejuar qe e gjitha apo nje pjese e te drejtave tatimore te shtyra te perdoren. Te drejtat tatimore te shtyra te panjohura rivleresohen ne çdo date bilanci dhe njihen deri ne ate nivel qe eshte e mundshme qe fitimi i ardhshem i tatueshem do te mundesoje qe te drejtat tatimore te shtyra te rimerren.

Te drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat e taksave qe priten te zbatohen ne vitin ne te cilin nje e drejte krijohet apo nje detyrim shlyhet, i bazuar ne normat e taksave (dhe ligjet per to) te fuqizuara apo pothuajse te fuqizuara ne daten e bilancit.

Tatimi aktual apo i shtyre qe lidhet me zera te cilet njihen menjehere ne kapital njihen gjithashtu ne nje rezerve ne kapital dhe jo ne pasqyren e te ardhurave.

Te drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore shmangen nese nje e drejte e detyrueshme ligjore ekziston per te krijuar nje te drejte tatimore aktuale kundrejt nje detyrimi tatimor aktual dhe tatimet e shtyra lidhen me te njejtet subjekte te tatueshem dhe autoritet tatimor.

#### (i) Aktivet dhe detyrimet financiare

##### (i) Njohja

Banka fillimisht njeh huate dhe paradheniet, depozitat dhe huamarrjet ne daten kur behen efektive. Blerjet dhe shitjet e rregullta te aktiveve financiare njihen ne ditën e tregtimit kur banka realizon blerjen ose shitjet e aktivitetit. Te gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht ne daten e tregtimit ne te cilen Banka behet pale per respektimin e dispozitave kontraktuale per instrumentin.

##### (ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabel 3(j) (k) (l) dhe (m).

##### (iii) Mos-njohja

Banka nuk e njeh nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale per perfitimin e parave nga aktivi nuk jane me efektive, ose kur transferohen te drejtat per te marre perfitimin kontraktual nga aktivi financiar ne nje transakcion per te cilin transferohen te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise mbi aktivin financiar. Çdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe krijohet ose mbahet nga Banka njihet si nje aktiv ose detyrim me vete. Banka nuk njeh nje detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale nuk mbahen, anulohen ose kur i skadon afati.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (iii) Mos-njohja (vazhdim)

Banka kryen transaksione nepermjet te cilave transferon aktivet qe njihen ne bilancin e saj kontabel, por nuk merr persiper asnje nga rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme, apo ndonje pjese te tyre. Ne rast se Bank merr persiper te gjitha rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme, atehere aktivet e transferuara njihen ne bilancin kontabel. Transferimi i aktiveve, nderkohe qe merren persiper te gjitha rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme perfshin kreditimin e letrave me vlere dhe transaksionet e riblerjes.

Per transaksione ku Banka nuk mban dhe as transferon rreziqet dhe shperblimet aktuale ose te mevonshme, ajo nuk e njeh aktivin ne rast se nuk ka kontroll mbi aktivin. Te drejtat dhe detyrimet qe mbahen gjate transferimit njihen me vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Ne transferime, ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon te njoh aktivin per aq kohe sa ky aset rezulton i perfshire, e cila percaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve ne vleren e aktivit te transferuar .

Banka fshin kredi te caktuara te cilat percaktohen si kredi te pakthyeshme (shih shenimin 4).

Mbulimi per nje ze te fshire nga bilanci regjistrohet nen zerin Te ardhura/shpenzime te tjera ne pasqyren e te ardhurave (shih shenimin 28).

#### (iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlere neto paraqitet ne bilancin kontabel kur, dhe vetem kur Banka gezon te drejten ligjore per te bere kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qellim likuidimin neto te aktivitet ose marrjen e aktivitet dhe njekoheshit likuidimin e detyrimit. Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetem kur lejohen nga standartet e kontabilitetit, ose tek fitimi ose humbjet te cilat rezultojne nga realizimi i transaksioneve te ngjashme si ne aktivitetin tregtar te Bankes.

#### (v) Matja me kosto te amortizuar

Kosto e amortizuar e aktivitet ose detyrimit financiar perben shumen me te cilen aktivi dhe detyrimi financiar matet ne fazen e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vleren e amortizimit te akumuluar duke perdorur metoden e interesit efektiv per te gjitha ndryshimet midis shumave fillestare qe eshte njohur dhe shumave se maturuar, duke zbritur ndonje humbje nga zhvleresimi.

#### (vi) Matja me Vlere Reale

Percaktimi i vleres reale te aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet ne çmimet e kuotuar ne treg ose çmimet e kuotuar nga agjenti per instrumentet financiare te cilat tregtohen ne tregjet aktive. Per te gjitha instrumentat e tjere financiare vlere reale percaktohet me ane te teknikave te vleresimit. Teknikat e vleresimit perfshijne teknikat e vleres aktuale neto, metoden e zbritjes se fluksit te mjeteve monetare, krahasimin me instrumente te ngjashme per te cilat ne treg ekzistojne çmimet perkatese, dhe modelet e vleresimit. Banka perdor modele vleresimi te njohura gjeresisht per percaktimin e vleres reale te instrumenteve te zakonshme financiare dhe te thjeshta si opsionet dhe norma e interesit dhe kembimet valutore swap. Per keto instrumente financiare informacionet qe perdoren ne modele jane te dukshme ne treg.



# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimeve

Ne çdo date te bilancit kontabel, Banka vlereson nese ekzistojne prova objektive qe aktivet financiare te cilat nuk jane mbajtur me vleren reale me efekt ne pasqyren e te ardhurave jane te zhvleresuara. Aktivet financiare konsiderohen te zhvleresuara nese vertetohet qe humbja ka ndodhur pas njohjes fillestare te aktivitetit, dhe se humbja do te influencoje ne te ardhmen fluksin e mjeteve monetare te aktivitetit, si dhe te mund te vleresohet besueshem.

Banka e konsideron zhvleresimin e aktivitetit ne aspektin specifik dhe kolektiv. Te gjitha aktivet financiare te rendesishme vleresohen vecmas per zhvleresime specifike. Te gjitha aktivet e rendesishme te cilat nuk rezultojne te zhvleresuara ne vecanti, vleresohen te gjitha se bashku per ndonje zhvleresim qe mund t'i kete ndodhur, por nuk eshte identifikuar ende. Aktivet qe nuk jane te rendesishme me vete vleresohen se bashku per identifikimin e zhvleresimit, duke grupuar se bashku aktivet financiare (te mbajtura me koston e amortizuar) te cilat paraqesin karakteristika te ngjashme te riskut.

Prova objektive qe verteton zhvleresimin mund te jete mospermbushja e detyrimeve dhe shkelja nga ana e klientit, ristrukturimi i kredise ose paradhenies nga banka me kushte ku Banka nuk merr ne konsiderate faktin qe huamarresi ose emetuesi do te shpalle falimentin, zhdukjen nga tregu aktiv per siguri, ose te dhena te tjera qe ekzistojne lidhur me nje grup aktivesh si ndryshime jo te favorshme ne statusin e likuidimit te huase se kredimarresit ose emetuesit ne grup, apo te kushteve ekonomike qe lidhen me mospermbushjen e detyrimeve ne grup.

Huate dhe paradheniet qe u jepen klienteve klasifikohen si nenstandart; te dyshimta; te humbura; te ristrukturuara sipas percaktimeve te Bankes Qendrore te Shqiperise, dhe nese u ka kaluar afati per me shume se 30 dite, ato behen subjekt i vleresimit individual per identifikimin e zhvleresimit specifik.

Banka vlereson per identifikime te zhvleresimeve individuale perkrah huave me probleme, ato hua te cilat ne daten e vleresimit jane me vonese me me shume se 30 dite. Ky zhvleresim matet si diference ndermjet vleres se mbartur te kredise, dhe vleres aktuale te fluksit te parashikuar te te ardhurave, duke marre ne konsiderate flukset e te ardhurave nga mbulimet e pengjeve dhe/ose garancive te cilat sigurojne keto ekspozime. Ne rast se rezulton nje humbje, vlere e mbartur e kredise zvogelohet nga fondi i krijuar per zhvleresimin e mundshem, i njohur me pare ne pasqyren e te ardhurave.

Pas ushtrimit te mesiperem, zhvleresimet varen nga faktore te tjere ose parametra vleresimi te cilat perdoren per llogaritjen e vleres aktuale te flukseve te ardhshme te te ardhurave, si p.sh.: vlere e realizueshme e pengjeve ose koha e realizueshme e flukseve te pritshme te te ardhurave.

Te gjitha klientet qe kane linja huaje te ristrukturuara jane subjekt i vleresimit per zhvleresim individual. Ato mbeten pjese e ketyre vleresimeve per nje periudhe prej nje viti nga data e ristrukturimit dhe/ose dates se riskedulimit, pavaresisht nga pagesat e kryera ne vazhdimesi te kushteve te reja te ripagimit.

Te gjitha huate per te cilat "nuk identifikohen prova objektive zhvleresimi" vleresohen ne menyre kolektive. Vleresimi kolektiv behet sipas grupeve te kredive me karakteristika te ngjashme risku, dhe duke marre ne konsiderate historikun e normave te humbjes dhe perqindjeve perkatese per humbjet nga kredite, ne baze te elementeve te dukshem ne daten e bilancit. Vleresimi merr parasysh dhe riskun qe paraqet vendi i huamarresit.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimeve (vazhdim)**

Humbjet nga zhvleresimi i aktiveve maten ne baze te diferences se shumes se mbartur te aktiveve financiare dhe vleres reale te fluksit te perlllogaritur te mjeteve monetare te skontuar me normen fillestare efektive te interesit te aktiveve. Humbjet njihen tek pasqyra e te ardhurave ne llogarine e fondit te zhvleresimit per huate dhe paradheniet. Interesi i aktivitetit te zhvleresuar vazhdon te njihet njesoj nepermjet skontimit.

Kur nje ngjarje e mevonshme influencon ne zvogelimin e shumes se humbjes nga zhvleresimi i aktivitetit, humbja kthehet tek pasqyra e te ardhurave.

#### **(j) Mjete monetare dhe te ngjashme**

Mjete monetare dhe te ngjashme perfshijne mjetet ne arke, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afat shkurtra shume likuide me maturitet me pak se 3 muaj, te cilat jane subjekt i ndryshimeve jo te rendesishme te vleres se tyre reale dhe perdoren nga Banka per permbushjen e angazhimeve te saj afatshkurtra.

Mjete monetare dhe te ngjashme mbahen ne bilanc me koston e amortizuar.

#### **(k) Aktive dhe detyrime te tregtueshme**

Aktive dhe detyrime te tregtueshme konsiderohen ato aktive dhe detyrime qe Banka blen ose merr kryesisht per qellimin e shitjes ose riblerjes brenda nje afati te shkurter, ose mban si pjese te nje portofoli qe administrohet per realizimin e fitimit dhe marrjen e pozicionit brenda nje afati te shkurter.

Aktivitet dhe detyrimet te tregtueshme njihen fillimisht dhe me pas maten me vleren reale ne bilanc me shpenzimet per transaksione te cilat pasqyrohen direkt tek pasqyra e te ardhurave. Te gjitha ndryshimet ne vleren reale njihen ne pasqyren e te ardhurave si pjese e te ardhurave te tjera nga tregtueshmeria te fitimi ose humbjet. Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare te tyre.

#### **(l) Huate dhe paradheniet**

Huate dhe paradheniet jane aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme te cilat nuk jane te kuotuar ne nje treg aktiv dhe Banka nuk ka per qellim shitjen e tyre te menjehershme ose ne nje kohe te afert. Huate dhe paradheniet maten ne fillim me koston e amortizimit plus koston e tjera te transaksioneve direkte, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(m) Investime ne Letra me Vlere**

Letrat me vlere kontabilizohen ne varesi te klasifikimit te tyre, si letra me vlere te investimit, letra me vlere te tregtueshme ose letra me vlere te vendosjes.

##### **(i) Letra me vlere te investimit**

Letrat me vlere te investimit jane aktive financiare jo derivative me te ardhura fikse ose te percaktueshme dhe me maturitete fikse qe Banka ka qellimin dhe aftesine t'i mbaje deri ne maturim dhe qe nuk klasifikohen si te tregtueshme ose letra me vlere te vendosjes.

Letrat me vlere te investimit maten me koston e amortizuar nepermjet metodes se interesit efektiv. Te gjitha shitjet dhe riklasifikimet e nje shume te konsiderueshme te letrave me vlere te investimit qe nuk jane afer maturimit riklasifikohen si investime ne letra me vlere te vendosjes dhe nuk e lejojne Banken t'i klasifikojte ato ne investime ne letra me vlere te investimit per vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet ushtrimore te ardhshem.

##### **(ii) Letra me vlere te vendosjes**

Letrat me vlere te vendosjes jane instrumente jo derivative te cilat nuk perbejne nje kategori tjetere te aktiveve financiare. Te ardhurat nga interesi njihen ne pasqyren e te ardhurave nepermjet metodes se interesit efektiv. Te ardhurat nga dividendet njihen ne pasqyren e te ardhurave kur Banka gezon te drejten mbi dividendin. Fitimet ose humbjet nga kembimet valutore te investimeve ne letra me vlere te vendosjes njihen ne pasqyren e te ardhurave.

Ndryshime te tjera te vleres reale njihen direkt ne kapital deri sa investimi te shitet ose zhvleresohet, kur gjendja ne kapital njihet me pas ne pasqyren e te ardhurave.

#### **(n) Ndertese dhe pajisjet**

##### **(i) Njohja dhe matja**

Ndertese dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre neto pasi u eshte zbritur zhvleresimi i akumuluar dhe ndonje humbje nga demtimi. Kostot perfshijne te gjitha shpenzimet te cilat mund t'i njihen ne menyre te drejtperdrejte blerjes se mjetit. Nese pjese te nje mjete kane jete perdorimi te ndryshme, atehere keto pjese kontabilizohen si elemente te vecanta (perberesit kryesore) te mjeteve te qendrueshem te trapezuara.

##### **(ii) Kosto te tjera rrjedhese**

Kostot e zevendesimit te nje pjese te nje ndertese ose pajisjeje njihen ne koston e aktivitetit nese eshte e mundur qe te sigurohen te mira te ardhshme ekonomike dhe nese kostot e tij mund te maten ne menyre te besueshme.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (n) Ndertesa dhe pajisje (vazhdim)

(iii) Zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave duke perdorur metoden lineare pergjate kohezgjatjes se jetes se perdorimit te çdo pjese te ndertesës dhe pajisjes. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvleresohen.

Ndryshimet ne jetegjatesine e pritshme te perdorimit kontabilizohen duke ngarkuar periudhen ose metoden e zhvleresimit ne varesi te rastit, dhe trajtohen si ndryshime ne perlllogaritjet (parashikimet) kontabel.

Jetegjatesite e parashikuara te perdorimit per periudhen aktuale dhe periudhen krahasuese jane te paraqitura si me poshte:

- Ndertestat 20 vjet
- Mobiljet, orendite dhe pajisjet 5 vjet
- Kompjuterat dhe pajisje te tjera kompjuterike 4 vjet

#### (iv) Mos-njohja

Ndertestat dhe pajisjet nuk njihen me ne momentin kur hiqen te drejtat dhe kontrolli mbi to dhe kur nga perdorimi i tyre asnje perfitim ekonomik ne te ardhmen nuk pritet te realizohet. Çdo humbje apo fitim nga mosnjohja e nje aktivi (te llogaritur si diference ndermjet te ardhurave nga vlera e shitjes dhe vleres se tij te mbartur) njihet ne kategorine “Te ardhura te tjera operacionale” ne pasqyren e te ardhurave ne vitin ne te cilin ndodh mosnjohja.

#### (o) Mjete te qendrueshme te patrupezuara

Programet kompjuterike, licensat dhe markat tregtare perbejne mjetet e qendrueshme te patrupezuara. Programet e blera nga Banka paraqiten me koston neto nga amortizimi i akumuluar.

Shpenzimet e metejshe ne mjetet e qendrueshme te patrupezuara kapitalizohen vetem nese keto shpenzime rrisin te mirat e ardhshme ekonomike te ketij mjeti specifik. Çdo lloj kostoje tjeter shpenzohet ne periudhen ne te cilen kryhet.

Amortizimi pasqyrohet te pasqyra e te ardhurave duke perdorur metoden lineare te amortizimit per te gjithë jetegjatesine e mjeteve te qendrueshme te patrupezuara. Mjetet e qendrueshme te patrupezuara amortizohen nga data e fillimit te perdorimit te tyre. Jetegjatesia e parashikuar per periudhen aktuale dhe krahasuese vijon si me poshte:

- Programet kompjuterike 4 vjet
- Licensat dhe markat tregtare 10 vjet

#### (p) Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo financiare te Bankes, te ndryshme nga aktivet tatimore te shtyra, rishikohet çdo date raportimi, per te percaktuar nese ka tregues te zhvleresimit. Ne rast se rezultojne tregues te tille, atehere perlllogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitet.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(p) Zhvleresimi i aktiveve jo financiare (vazhdim)**

Humbjet nga zhvleresimi njihen nese shuma e mbartur e nje aktivi ose njesie qe gjeneron te ardhura e tejkalon shumen e vleres se rikuperimit. Njesia qe gjeneron te ardhura eshte grupi me i vogel i aktivitetit, i identifikueshem qe gjeneron flukse te mjeteve monetare te cilat jane shume te pavaruara nga aktivitetet e tjera dhe grupet. Humbjet nga zhvleresimi njihen tek fitimi ose humbjet. Humbjet nga zhvleresimi lidhur me njesite e gjenerimit te te ardhurave shperndahen per te reduktuar shumen e mbartur te aktiveve te tjera ne njesi (grup njesish) ne menyre proporcionale.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi ose njesie gjenerimi te te ardhurave eshte me e madhja prej vleres ne perdorim dhe vleres reale pa kostot per t'u shitur. Per vleresimin e vleres ne perdorim, fluksi i te ardhurave te parashikuara skontohej ne vleren aktuale me normen e zbritjes para tatimit e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut me vleren kohe te parase dhe risqet specifike te aktivitetit.

Humbjet nga zhvleresimi te njohura gjate periudhave te meparshme vleresohen ne daten e raportimit per te verifikuar nese ka tregues qe pasqyrohen se humbjet jane zvogeluar ose nuk jane me ekzistente. Humbjet nga zhvleresimi kthehen ne rast se ka pasur ndonje ndryshim ne perlllogaritjet e bera per percaktimin e shumes se rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi kthehen vetem kur shuma e mbartur e aktivitetit nuk e tejkalon shumen e mbartur qe do te ishte percaktuar, pa zhvleresimin dhe amortizimin, nese nuk do te njihej asnje humbje nga zhvleresimi.

#### **(q) Depozitat dhe borxhet e varura**

Depozitat dhe borxhet e varura perbejne burimet e financimit te Bankes.

Kur Banka shet nje aktiv financiar dhe ne te njejten kohe nenshkruan nje marreveshje per riblerjen e aktivitetit (ose te nje aktivi te ngjashem) me çmim fiks ne nje date te me vone ("repo" ose "stock lend+ing") marreveshja kontabilizohet si depozite, dhe aktivi ne fjale vazhdon te njihet ne pasqyrat financiare te Bankes.

Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vleren reale plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre te amortizuar duke perdorur metoden e normes efektive te interesit, pervecse kur Banka vendos te mbart detyrime me vleren reale nepermjet njohjes se fitimit – humbjeve.

#### **(r) Marreveshjet e riblerjes dhe marreveshjet e ndersjellta te riblerjes**

Letrat me vlere te blera sipas marreveshjeve per t'u rishitur (marreveshjet per riblerjet e ndersjellta) dhe letra me vlere te shitura sipas marreveshjeve per te riblere (marreveshjet per riblerje), trajtohen si transaksione financiare me kolateral ne formen e parapagimeve ose arketimeve plus interesin e perlllogaritur.

Letrat me vlere te marra mbi bazen e marreveshjeve te riblerjes se ndersjellte dhe letrat me vlere te dhena sipas marreveshjeve te riblerjes nuk njihen ose hiqen nga bilanci, derisa hiqet dore nga kontrolli i te drejtave kontraktuale te cilat perfshijne keto letra me vlere.

# **Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.**

## **Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.**

*(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)*

---

### **3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

#### **(r) Marreveshjet e riblerjes dhe marreveshjet e ndersjellta te riblerjes (vazhdim)**

Interesat e fituara nga marreveshjet e riblerjeve te ndersjellta dhe interesi i marreveshjeve te riblerjeve njihen si te ardhura nga interesat ose shpenzime interesi per secilen marreveshje, mbi jeten e çdo marreveshje. Te gjitha marreveshjet e riblerjes dhe marreveshjet e ndersjellta jane bere me Banken Qendrore te Shqiperise.

#### **(s) Fondet rezerve**

Nje fond rezerve mund te njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje ne te kaluaren Banka disponon nje detyrim ligjor ose konstruktiv qe mund te vleresohet me besueshmeri dhe qe gjithashtu eshte e mundur qe te kerkoje dalje te perfitimeve ekonomike per te mbyllur detyrimin. Provigjionet percaktohen duke perdorur si norme skontimi per flukset e pritshme te parase ne te ardhmen , nje norme para taksore e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe aty ku eshte e pershtatshme edhe specifikat e riskut per detyrimin.

#### **(t) Garancite Financiare**

Garancite financiare jane kontrata qe kerkojne qe Banka te realizoje pagesa specifike per te rimbursuar mbajtessin e garancise per nje humbje qe ka ndodhur si rezultat i mungeses se pageses sipas termave kontraktore per nje instrument borxhi nga nje debitor i caktuar.

Detyrimet per garancite financiare njihen fillimisht me vleren e tyre reale, e cila amortizohet gjate jetes se garancise financiare. Rrjedhimisht detyrimi i garancise mbartet me vleren me te larte midis vleres se amortizuar dhe vleres aktuale te ndonje pagese te pritshme. (kur pagesa ne lidhje me garancine behet e mundshme).

Garancite financiare jane te perfshira tek detyrime te tjera.

#### **(u) Perfitimet e punonjesve**

##### **(i) Planet e percaktuara te kontributeve**

Banka operon vetem me kontribute te detyrueshme te sigurimeve shoqerore qe sigurojne perfitime pensioni per personelin ne momentin e daljes ne pension. Autoritetet lokale jane pergjegjes per te siguruar minimumin e nivelit te pensionit sipas ligjit per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani te percaktuar kontributi per pensionin. Kontributet e Bankes ndaj perfitimeve te planit te pensionit pasqyrohen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ndodhin.

##### **(ii) Perfitimet afatshkurter**

Detyrimet ndaj perfitimeve afatshkurter te punonjesve llogariten mbi nje baze te paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur sherbimi perkates eshte siguruar. Nje provigjion njihet per vleren e pritur per t'u paguar neqoftese Banka ka nje detyrim aktual ligjor ose konstruktiv per te paguar kete shume si rezultat i nje sherbimi te kryer ne te kaluaren nga punonjesi dhe ky detyrim mund te vleresohet saktesisht.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (standartet e reja, ndryshimet/rishikimet te standarteve ose interpretimeve te tyre) efektive per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2008.

(i) Interpretimet dhe ndryshimet (amendimet) e standarteve te meposhtem u bene te detyrueshem per here te pare per vitin financiar te filluar me 1 Janar 2008:

**IFRIC 11, “SNRF 2 – Transaksionet ne Grup dhe te Thesarit”.** IFRIC 11 kerkon marreveshje ku nje punonjesi i jepet e drejta te bleje aksione, te merret ne konsiderate ne skemat e aksioneve qe krijohen nga entiteti ku eshte i punesuar, edhe nese entiteti zgjedh ose i kerkohet te bleje keto aksione nga nje pale tjetere, ose nga aksioneret e vete entitetit ne fjale te cilet ofrojne keto instrumenta kapitale te dhuruara. Interpretimi shtrihet dhe ne menyren ne te cilen filialet, ne pasqyrat e tyre financiare te vecanta, marrin ne konsiderate te tilla skema kur punonjesve te tyre i jepen te drejta per te marre instrumenta kapitali te kompanise meme. Interpretimi i referohet menyres sesi njesia konsideron ne pasqyrat e saj individuale financiare, opsionet e dhuruara punonjesve per te blere aksione te Kompanise. IFRIC 11 nuk eshte i aplikueshem per veprimtarine e Bankes.

**IFRIC 12, “Marreveshjet per Konkensionet e Sherbimeve”** . Ky interpretim cileson menyren per marrjen ne konsiderate te marreveshjes kontraktuale (konkensionit te sherbimeve) qe lind si pasoje e entiteteve qe ofrojne sherbime publike. Ky standard parashikon qe operatori nuk duhet ta konsideroje infrastrukturen si prone, mjete dhe pajisje, por ta njohe si nje aktiv financiar dhe/ose nje mjet te qendrueshem te patrupezuar. IFRIC 12 nuk eshte i aplikueshem per veprimtarine e Bankes.

**IFRIC 14, “IAS 19 – Kufiri ne Perfitimet e Percaktuara te nje Aktivi, Kerkesat Minimale te Financimit dhe Marredheniet ndermjet tyre”.** IFRIC 14 ofron drejtimin sesi te vleresohet kufiri mbi vleren e tejkaluar ne nje skeme te percaktuar te perfitimeve qe mund te njihen si nje aktiv sipas IAS 19 per perfitimet e punonjesve. Ajo gjithashtu shpjegon sesi ky limit, gjithashtu i ashtuquajtur “testimi i aktivitet tavan”, mund te influencohet nga nje kerkese minimale financimi dhe ka per qellim te standartizojte praktiken aktuale. IFRIC 14 nuk eshte i aplikueshem per veprimtarine e Bankes.

**IAS 39, “Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja” dhe SRNF (IFRS) 7 “Instrumentat Financiare: Sqarimet; Riklasifikimi i Aktiveve Financiare” (Amenduar),** ka hyre ne fuqi qe me date 1 Korrik 2008 dhe nuk mund te zbatohet ne menyre retrospektive per periudhat raportuese perpara dates se hyrjes ne fuqi. Amendimi i IAS 39 lejon qe nje entitet ne rrethana te caktuara te riklasifikojte aktivet financiare jo derivative (te tjera pervec atyre te klasifikuara me vlere reale nepermjet fitimit ose humbjes nga entiteti ne njohjen fillestare te tyre) jashte kategorise se vlere reale nepermjet fitimit ose humbjes (VRNFH). Amendimi gjithashtu lejon nje entitet te transferojte nga kategoria e letrave me vlere te investimit te kategoria e huadhenieve dhe paradhanieve nje aktiv financiar qe do t'i permbushte kriteret e ketij klasifikimi te fundit (nese ky aktiv financiar nuk do te ishte klasifikuar si letra me vlere te investimit), nese entiteti do te kishte qellimin dhe mundesine per ta mbajtur kete aktiv financiar deri ne nje te ardhme te afert. Amendimet nuk lejojne riklasifikimet ne VRNFH. Amendimet e SRNF 7 lidhen me dhenien e sqarimeve (per palet e interesuara) qe kerkohen per nje aktiv financiar qe ka qene riklasifikuar dhe qe nuk eshte relevant per Banken pasi asnje riklasifikim nuk eshte bere.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (vazhdim)

ii) Standartet e reja te meposhtme, amendimet kundrejt standarteve dhe interpretimet jane publikuar por nuk jane efektive per vitin financiar te filluar me 1 Janar 2008:

**IFRIC 13, “Programet e Besnikerise se Klienteve”,** ne fuqi per vitet financiare duke filluar ne ose pas 1 Korrik 2008. Ky Interpretim kerkon qe shperblimet per besnikerine e klienteve te merren ne konsiderate si nje perberes i veçante i transaksioneve te shitjeve ne te cilat ato jane ofruar dhe ateherë nje pjese e vleres reale te kesaj konsiderate te marre, vendoset si pjese e shperblimit te dhene dhe shtyhet ne kohe derisa keto kredite shperblimi plotesohen. IFRIC 13 eshte detyruar per pasqyrat financiare 2009 te Bankes dhe do te jene te aplikueshem ne menyre retrospektive. Banka eshte aktualisht ne procesin e vleresimit potencial te matjes se efektit te ketij interpretimi.

**IFRIC 15, “Marreveshjet per Ndertimin e Pasurive te Paluajtshme”,** ne fuqi per vitet financiare duke filluar ne ose pas 1 Janar 2009 dhe te aplikueshme ne menyre retrospektive. IFRIC 15 ofron udhezime sesi te percaktohet nese nje marreveshje per ndertimin e nje pasurie te paluajtshme eshte brenda qellimit te IAS 11 ‘Kontratat e Ndertimit’ ose IAS 18 ‘Te ardhurat’ dhe, si rrjedhoje, kur keto te ardhura nga keto kontrata duhet te njihen. IFRIC 15 nuk eshte i aplikueshem per veprimtarine e Bankes pasi Banka nuk ofron sherbime per ndertimin e pasurive te paluajtshme apo te zhvilloje pasuri te paluajtshme per shitje.

**IFRIC 16, “Mbrojtjet e Investimeve Neto ne nje veprimtari te huaj”,** ne fuqi per vitet financiare qe fillojne ne ose pas 1 Tetor 2008 i cili duhet te zbatohet ne menyre prospektive. IFRIC 16 qarteson kryesisht tre çeshtje si me poshte:

-Monedha raportuese nuk krijon nje ekspozim kundrejt te cilit nje entitet mund te aplikojë kontabilitetin mbrojtës (hedge accounting). Rrjedhimisht, entiteti meme mund te klasifikojë si te mbrojtura nga risku (hedged risk) vetem ndryshimet nga kurset e kembimit qe dalin si pasoje e diferencave ndermjet monedhes se vet funksionale dhe operatorit te saj te huaj.

-Instrumentat mbrojtës (hedging instruments) mund te mbahen nga kushdo entitet apo entitete brenda grupit.

-Ndersa IAS 39, ‘Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja’, duhet te zbatohet per te percaktuar vleren e duhur per t’u riklasifikuar ne fitim ose humbje nga rezerva e krijuar per diferencat nga konvertimi i monedhave te huaja, ne lidhje me instrumentin mbrojtës, IAS 21 duhet zbatuar ne lidhje me mjetin e mbrojtur (hedged item).

Interpretimi lejon nje entitet qe perdor metodën hap-pas-hapi te konsolidimit te zgjedhe nje politike kontabel per te percaktuar korrigjimin e akumuluar nga konvertimi i monedhave te huaja qe eshte riklasifikuar ne fitim ose humbje ne momentin e heqjes dore nga pronesia e nje investimi neto, njesoj sikur metoda direkte e konsolidimit te ishte perdorur. IFRIC 16 eshte i zbatueshem ne menyre prospektive per marredheniet ekzistuese mbrojtëse (hedge relationships) dhe investimeve neto te entitetit. Ky Interpretim nuk pritet te kete ndonje efekt per pasqyrat financiare te Bankes.

**IFRIC 17, “Shperndarjet e Aktiveve jo ne vlere monetare te Aksioneret”,** ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Korrik 2009. IFRIC 17 eshte i zbatueshem per shperndarjet jo-reciproke te aktiveve jo ne vlere monetare tek aksioneret, qe veprojnë me cilesite e tyre si te tille. Sipas Interpretimit detyrimi per te paguar dividendet duhet te njihet kur dividenti autorizohet ne menyren e pershtatshme dhe nuk eshte me pjese e konfidencialitetit te entitetit dhe do te matet me vleren reale te aktiveve qe do te shperndahen.



# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (vazhdim)

##### **IFRIC 17, “Shperndarjet e Aktiveve jo ne vlerë monetare te Aksioneret” (vazhdim)**

Vlera e mbartur e dividendit per t’u paguar duhet te ri-matet ne cdo date raportimi, me cdo ndryshim ne vleren e mbartur e cila eshte e njohur ne kapital si korrigeime te vleres qe do te shperndahet. Pasi te jete percaktuar shuma e dividendeve te pagueshem, diferenca, nese ka, ndermjet vleres se mbartur te aktiveve te shperndara dhe vleres se mbetur te dividendeve per t’u shperndare, njihet ne fitim ose humbje. Duke qene se Interpretimi eshte i zbatueshem vetem nga data e fillimit te zbatimit, ai nuk ka ndikim ne pasqyrat financiare per periudhat perpara dates se adoptimit te ketij interpretimi. Me tej, ky interpretim lidhet me dividendet e ardhshem qe do te jene nen konfidencialitetin e bordit te drejtoresve/aksionereve dhe nuk eshte e mundur te percaktohen ne avance efektet e zbatimit.

**IFRIC 18, “Transferimet e Aktiveve nga Klientet”,** ne fuqi ne menyre prospektive per transferimet e aktiveve te marra ne ose pas 1 Korrik 2009. Interpretimi zbatohet nga ana kontabile nga entitete qe marrin kontribute ne prona, pajisje dhe makineri nga klientet e tyre. Ky Interpretim i kerkon nje entiteti qe merr kontribute qe i permbahen qellimit te interpretimit te njohe nje mjet si nje aktiv ne vleren reale te tij, nese ky i fundit i ploteson kushtet per tu konsideruar si prone, paisje dhe makineri sipas IAS 16. Interpretimi gjithashtu i kerkon nje entiteti te njohe vleren si te ardhur; koha e njohjes se te ardhurave do te jete ne varesi te fakteve dhe rrethanave te seciles marreveshje ne fjale. Interpretimi nuk eshte i aplikueshem per pasqyrat financiare te Bankes, pasi Banka normalisht nuk ka qellimin te marre nga klientet kontributet e aktiveve.

**IAS 39, “Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja” dhe IFRIC 9, “Rivleresimi i derivativeve te perfshire (embedded derivatives)” (Amenduar),** ne fuqi per periudha vjetore qe perfundojne ne ose pas 30 Qershor 2009. Ky amendim qarteson trajtimin kontabel te derivativeve te perfshire per entitetet qe perdorin Amendimin e Riklasifikimit te leshuar nga IASB ne Tetor 2008. Amendimi i riklasifikimit i jep mundesine nje entiteti ne menyre te veçante per instrumentat e tij financiare ne rrethana te veçanta t’i riklasifikoje jashte kategorise se ‘vleres reale nepermjet fitimit ose humbjes’. IFRIC 9 i amenduar dhe IAS 39, qartesoje qe riklasifikimi i nje aktivi financiar jashte kategorise se ‘vleres reale nepermjet fitimit ose humbjes’, ndikon ne faktin qe te gjithë derivativet e perfshire duhet te vleresohen dhe nese eshte e nevojshme, te merren ne konsiderate ne pasqyrat financiare veçmas. Amendimet jane te zbatueshme ne retrospektive dhe kerkohen qe te zbatohen. Siç eshte permendur dhe me siper, Banka nuk ka ne perdorim asnje riklasifikim; si pasoje ky amendim nuk eshte i aplikueshem.

**SNRF 1, “Adoptimi i Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar” per here te pare dhe IAS 27, “Pasqyrat Financiare te Konsoliduara dhe te Veçanta” (Amenduar),** ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. SNRF 1 mundeson nje entitet te percaktoje ‘koston’ e investimeve ne filiale, pjesemarrje apo siperemarrje te perbashketa ne hapjen e pasqyrave financiare sipas SNRF ne perputhje me IAS 27 ose duke perdorur nje kosto te parashikuar. IAS 27 kerkon qe te gjithë dividendet nga nje filial, pjesemarrje apo siperemarrje te perbashket te njihen ne pasqyren e te ardhurave ne nje pasqyre financiare te veçante. Amendimi i IAS 27 duhet te aplikohet ne menyre prospektive. Kerkesat e reja ndikojne vetem pasqyrat e veçanta financiare te entitetit meme dhe nuk kane ndikim ne pasqyrat financiare te konsoliduara. Banka nuk pret qe ky amendim te kete ndonje efekt ne pasqyrat e saj financiare.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IFRS 2, “Pagesat te bazuara ne aksione” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Amendimet qartesojne dy çeshtje. Perkufizimi i ‘kerkesave te fitimit te drejtes per te marre perfitime’, duke perfshire edhe termin ‘mos plotesim te kerkesave te fitimit te drejtes per te marre perfitime, per kushte te tjera pervec kushteve te sherbimeve dhe kushteve te ecurise se aktivitetit. Ajo gjithashtu qarteson qe i njeiti trajtim kontabel zbatohet per shperblimet qe nuk zbatohen efektivisht nga vete entiteti ose pala tjetere. IFRS 2 nuk eshte i aplikueshem per veprimtarine e Bankes pasi Banka nuk ka nje plan pagesash te tilla per personelin apo drejtoret e saj.

**IFRS 3, “Kombinimet e Biznesit” (E rishikuar) dhe IAS 27, “Pasqyrat financiare te Konsoliduara dhe te Veçanta” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Korrik 2009. Versioni i rishikuar i IFRS 3 paraqet nje sere ndryshimesh ne menyren e trajtimit te Kombinimeve te Biznesit, te cilat nuk ndikojne ne vleren e njohur te ‘emri i mire’, te rezultateve te raportuara ne periudhen qe nje blerje ndodh, dhe ne rezultatet per t’u raportuar ne te ardhmen. Keto ndryshime perfshijne qe kostot e lidhura me blerjen qe njihen si shpenzime dhe ndryshimet e metejshe me vleres te kesaj blerjeje te njihen ne fitim ose humbje (ne vend te korrjimit te ‘emri i mire’). IAS 27 e amenduar kerkon qe nje ndryshim ne interesat e pronesis mbi nje filial te konsiderohet si nje transakcion kapitali. Atehere, ky ndryshim nuk ka ndikim mbi ‘emri i mire’, dhe as nuk ndikon ne krijimin e nje fitimi apo humbjeje. Per me tej, standartet e amenduara ndryshojne menyren e te konsideruarit te humbjeve te realizuara nga filiali, si edhe humbjen e kontrollit mbi ate filial. IFRS 3 i rishikuar nuk eshte i aplikueshem per veprimtarine e Bankes.

**IFRS 8, “Segmentet Operacionale”, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. IFRS 8 zevendeson IAS 14 ‘Raportimi Segmentar’.** IFRS 8 permban nje metode afrimi menaxheriale per tek raportimi segmentar. Informacioni i raportuar duhet te jete i tille qe perdoret per perdorim te brendshem nga menaxhimi per te vleresuar ecurine e segmenteve operacionale dhe ndarjes se burimeve ne keto segmente. Ky informacion mund te jete i ndryshem nga ai qe raportohet ne bilancin kontabel dhe pasqyren e te ardhurave dhe entitetet jane te detyruar te japin shpjegime dhe rakordime te diferencave. Ky standart nuk do te kete impakt mbi fitimin ose humbjen apo kapitalin e raportuar te Bankes. Banka eshte aktualisht ne procesin e percaktimit te impaktit potencial te raportimit segmentar.

**IFRS 7, “Instrumentat Financiare: Dhenie Informacionesh Shpjeguese” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim kerkon qe matjet e vleres reale te sqarohen nga burimi i kontributeve, duke perdorur tre nivelet e meposhtme te hierarkise: a) Çmime te listuara (te pakorrigjuara) ne tregje aktive per aktive dhe detyrime identike (Niveli 1) (b) Kontribute te tjera pervec çmimeve te listuara te perfshira ne Nivelin 1 qe jane te evidentueshme per aktivin dhe detyrimin, qofte ne menyre direkte (si cmimet) ose indirekte (te derivuar nga cmimet) (Niveli 2) (c) Kontribute per aktivin ose detyrimin qe nuk jane te evidentueshme nga te dhenat e tregut (kontribute te paevidentueshme) (Niveli 3). Ky informacion duhet te jepet sipas klasave te instrumentit financiar. Amendimet gjithashtu rishikojne ne menyre specifike minimumin e sqarimeve te kerkuara per riskun e likuiditetit. Banka eshte duke vleresuar ndikimin e ketij amendimi ne pasqyrat e saj financiare, sidoqofte nuk pritet te kete ndonje ndikim te ndjeshem.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IAS 1, “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” (Rishikuar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. IAS 1 eshte rishikuar per te perforcuar dobishmerine e informacionit te prezantuar ne pasqyrat financiare. Nga rishikimet me te rendesishme jane kerkesat ne lidhje me pasqyren e konsoliduar te ndryshimeve te kapitalit e cila perfshin vetem transaksionet me aksioneret; futjen e nje kategorie siç eshte “fitimi nga vleresimi i kapitalit ne vite” qe kombinon te gjithë zerat e te ardhurave dhe shpenzimeve te njohura ne te ardhura dhe shpenzime se bashku me “diferenca nga vleresimi i kapitalit ne vite”; dhe kerkesa per te prezantuar rideklarimet e pasqyrave financiare ose zbatueshmerise retrospektive te nje politike kontabel ne fillim te periudhes me te hershme krahasimore, me fjale te tjera nje kolone te trete ne bilancin kontabel. Pasi ky version pritet te kete nje ndikim, Banka planifikon te beje ndryshimet e nevojshme per prezantimin e pasqyrave financiare ne vitin 2009, per te siguruar dhenien e vleres totale te “fitimi nga vleresimi i kapitalit ne vite” ne nje pasqyre te vetme te “fitimi nga vleresimi i kapitalit ne vite”.

**IAS 32 dhe IAS 1, “Instrumenta Financiare te Kthyeshem” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Amendimet e IAS 32 kerkojne qe disa instrumenta financiare te kthyeshem dhe detyrimet qe lindin ne momentin e likuidimit te klasifikohen si kapital nese disa kriteret plotesohen. Amendimi i IAS 1 kerkon qe te vihet ne dijeni per nje informacion te caktuar ne lidhje me instrumentat e kthyeshem te klasifikuara si kapital. Amendimet, te cilat behen te detyrueshme per pasqyrat financiare 2009 te Bankes per t’u zbatuar ne menyre retrospektive, nuk pritet te kene ndonje ndikim ne pasqyrat financiare.

**IAS 23, “Kostot e Huamarrjes” (Rishikuar)**, eleminon mundesine per te shpenzuar kostot e huamarrjes dhe kerkon qe entiteti te kapitalizojë kostot e huamarrjes qe jane direkt te atribueshme ndaj blerjes, ndertimit ose prodhimit te nje aktivi te cilesuar si pjese e kostos se atij aktivi. IAS 23 i rishikuar do te behet i detyrueshem per pasqyrat financiare 2009 te Bankes dhe do te perbeje nje ndryshim ne politiken kontabel te Bankes. Ne perputhje me kerkesat tranzitore, Banka do te aplikojë IAS 23 te rishikuar per aktivet e cilesuara per te cilat kapitalizimi i kostove te huamarrjes fillon ne ose pas dates efektive. Atehere, kjo nuk do te kete ndikim per periudhat e meparshme ne pasqyrat financiare 2009 te Bankes, per kostot e huamarrjes te krijuara ne ate date.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IAS 39, “Instrumenta Financiare: Njohja dhe matja” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Korrik 2009. Amendimet lidhen me zera qe gezojne te drejten te jene te mbrojtura dhe qe sqarojne aplikimin e parimeve ekzistuese qe percaktojne nese risku specifik ose pjese te rrjedhes se parase gezojne te drejten per klasifikim ne marredhenie te mbrojtura. Amendimet do te behen te detyrueshme per pasqyrat financiare te Bankes per vitin 2010, me aplikim retrospektiv. Aktualisht Banka eshte duke vleresuar efektin potencial te ketij amendimi.

iii) Ne Maj 2008, IASB-ja nxorri grupin e pare te amendimeve per standartet e tij, fillimisht duke rishikuar heqjen e mosperputhjeve dhe duke sqaruar formimin e shprehjeve. Keto amendime jane ne fuqi per periudha qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009.

**IFRS 5, “Aktive Afatgjata qe mbahen per t’u shitur dhe Operacionet jo te vijueshme” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Amendimi sqaron qe aktivet dhe pasivet e nje filiali jane klasifikuar per shitje, sipas IFRS 5, edhe nese entiteti do te kete nje interes jo kontrollues mbi entitetin pas shitjes. Per t’u aplikuar prospektivisht qe nga data ne te cilen Banka ka aplikuar per here te pare IFRS 5. Per rrjedhoje çdo investim ne dege, te klasifikuara per shitje, qe nga data kur eshte aplikuar IFRS 5, do te duhet te rivleresohet. Nje aplikim me i hershem eshte i lejueshem. IAS 27 (siç eshte amenduar ne Janar 2008) duhet te adoptohet qe nga ajo dite.

**IFRS 7, “Instrumentat Financiare: Dhenie Informacionesh Shpjeguese ” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim heq referencen e “te ardhurat nga interesat” si nje komponent i kostove te financimit.

**IAS 1, “Paraqitja e Pasqyrave Financiare ” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim sqaron se aktivet dhe pasivet te klasifikuara per tregtim, ne perputhje me IAS 39 Instrumentat Financiare: Njohja dhe matja, nuk jane automatikisht te klasifikuara si aktive dhe pasive likuide ne bilanc. Per t’u aplikuar retrospektivisht. Eshte i lejueshem nje aplikim i hershem.

**IAS 8, “Politikat Kontabel, Ndryshime ne Vleresimet Kontabel dhe Gabimet ” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim sqaron qe vetem nje udhezim implementimi, qe eshte nje pjese integrale e nje IFRS-je, eshte e detyrueshme kur zgjedh politikat kontabel.

**IAS 10, “Ngjarje pas Periudhes se Raportimit” (Amenduar)**, efektive per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim sqaron qe dividendet e deklaruar pas fundit te periudhes se raportimit nuk jane detyrime.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IAS 16, “Aktivet Afatgjata Materiale” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009.

-Zevendeson termin “çmimi neto i shitjes” me “vlera reale minus kostot per shitje” qe ka lidhje me shumat e rimarra, per te qene konsistent me IFRS 5 dhe IAS 36 Zhvleresimi i Aktiveve.

-Zerat Ndertesa, Trualli dhe Pajisje te mbajtura per dhenie me qera, qe jane shitur ne menyre rutine gjate jetes se biznesit pas dhenies me qera, transferohen ne inventar kur kontratat e qerese mbarojne dhe ato mbahen per shitje.

Fitimet nga shitja njihen si e ardhur. IAS 7 Pasqyra e flukseve monetare, eshte gjithashtu rishikuar, per te kerkuar qe pagesat ne mjete monetare per te prodhuar ose blere zera te tille te riklasifikohen si rrjedhje e parase nga aktivitetet operative. Parate e arketuara nga dheniet me qera dhe shitje te mevonshme te ketyre aktiveve jane paraqitur gjithashtu si rrjedhje e parase nga aktivitetet operative.

**IAS 18, “Te ardhurat” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim zevendeson termin “kosto direkte” me “kosto transaksioni” siç eshte percaktuar ne IAS 39.

**IAS 19, “Perfitimet e Punonjesve” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009.

-Rishikon perkufizimin e “kosto te shkuara te sherbimit” duke perfshire reduktime ne perfitimet qe lidhen me sherbimet e shkuara (“kostot e shkuara te sherbimit negative”) dhe perjashtuar reduktimet ne perfitimet qe lidhen me sherbimet ne te ardhmen qe rezultojne nga amendime planesh. Amendimet per plane qe rezultojne me nje reduktim ne perfitime qe lidhen me sherbime te ardhshme konsiderohen si nje shkurtim. Per t’u aplikuar ne periudhat e ardhshme – per ndryshimet ne perfitimet qe ndodhin ne ose pas 1 Janar 2009. Nje aplikim i hershem eshte i lejueshem.

-Rishikon perkufizimin e ‘fitimit mbi aktivet e planifikuara’ duke perjashtuar kostot administrative te planifikuara nese ato kane qene te perfshira ne supozimet e perdorura per te matur perfitimet e percaktuara te detyrimit.

Aplikohet ne menyre retrospektive. Nje aplikim i hershem eshte i lejueshem.

-Rishikon perkufizimin e perfitimeve te punonjesve ‘afat shkurter’ dhe ‘te tjera afat gjata’ per t’u perqendruar ne kohen kur detyrimi duhet te shlyhet. Aplikohet ne menyre retrospektive. Nje aplikim i hershem eshte i lejueshem.

-Fshin referencen e njohjes se detyrimeve per te siguruar konsistenca me IAS 37, Provigjionet, Aktivet dhe Pasivet e Kushtezuara. IAS 37 nuk lejon njohjen e detyrimeve jashte bilancit. Nje aplikim i hershem eshte i lejueshem.

**IAS 20, “Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhenia e Informacioneve Shpjeguese per Ndhimen Qeveritare”, (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Kredite e dhena pa ose me interes te ulet nuk perjashtohen nga kerkesat e perfshirjes se interesave. Interesi duhet te perfshihet ne kredite e dhena me norma interesi nen normat e tregut per interesat, duke qene ne kete menyre konsistent me IAS 39. Diferencat ndermjet vleres se marre dhe vleres se skontuar konsiderohet si grant qeveritar. Aplikohet ne menyre retrospektive – per kredite qeveritare te marra ne ose pas 1 Janar 2009. Nje aplikim i hershem eshte i lejueshem. Sidoqofte, SNRF 1 Adaptimi per Here te Pare i SNRF nuk eshte rishikuar per ata subjekte qe e kane pershtatur per here te pare SNRF; atehere atyre do t’u kerkohet te perfshijne interesat ne tepricat e kredive te ketij lloji ne daten e pershtatjes se SNRF.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IAS 23, “Kostot e Huamarrjes” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne me ose pas 1 Janar 2009. Kjo rishikon perkufizimin e kostove te borxhit per te bere te mundur konsolidimin ne nje te llojeve te mjeteve qe konsiderohen si pjese perberese e ‘kostove te huamarrjes’ – shpenzimet e interesave te llogaritur duke perdorur metoden e normes efektive te interesit si eshte pershkruar ne IAS 39. Te aplikohet ne menyre retrospektive. Aplikimi me i hershem eshte i lejueshem.

**IAS 27, “Pasqyrat Financiare te Konsoliduara dhe Individuale” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janarit 2009. Kjo kerkon qe ndryshimet e ndodhura ne interesat e pronesis tek nje filial pa humbur kontrollin mbi to te konsiderohen si transakcione kapitali. Kur Banka humbet kontrollin e nje filiali, çdo interes i mbajtur ne ish-filialin do te matet me vleren reale me fitim ose humbje te njohur ne pasqyren e te ardhurave. Amendimet e IAS 27, te cilat behen te detyrueshme per pasqyrat financiare 2010 te Bankes, nuk priten te kene ndonje ndikim te pasqyrat financiare.

**IAS 28, “Investimet ne Pjesemarrje”, (Amenduar)**, ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009.

-Nese nje pjesemarrje llogaritet me vleren e saj ne perputhje me IAS 39 (qe eshte e perjashtuar nga kerkesat e IAS 28), vetem kerkesat e IAS 28 bejne qe te jepen sqarime mbi natyren dhe nivelin e pengesave ne aftesine e partnerit te transferoje fonde te entiteti ne formen e kesh-it ose pagesave te kredive. Aplikimi i hershem eshte i lejueshem. Nese aplikohet shume shpejt, nje entitet duhet te aplikojte dhe amendimet e meposhtme, si edhe amendimet e paragrafit 3 te IFRS 7 Instrumentat Financiare: Sqarimet, paragrafi 1 i IAS 31 Interesat ne Siperemarrjet e Perbashketa dhe paragrafit 4 te IAS 32 Instrumentat Financiare: Prezantimi ne te njejten kohe.

-Nje investim ne nje Pjesemarrje te perbashket konsiderohet si nje aktiv i vetem per qellime te testimave per zhvleresim – duke perfshire edhe kthimin e zhvleresimeve. Atehere, çdo zhvleresim nuk vendoset ne menyre te veçante te ‘emri i mire’ i perfshire ne balancen e investimit. Çdo zhvleresim, kthehet nese vlera e rikuperueshme e interesit ne siperemarrjen e perbashket rritet. Nese aplikohet per periudha te hershme, nje entitet duhet gjithashtu te aplikojte ç’ka u permend me siper, dhe amendimet e paragrafit 3 te IFRS 7 Instrumentat Financiare: Dhenia e Informacioneve Shpjeguese, paragrafi 1 i IAS 31 Interesat ne Siperemarrjet e Perbashketa dhe paragrafin 4 te IAS 32 Instrumentat Financiare: Prezantimi ne te njejten kohe.

**IAS 29, “Raportimi Financiar ne Ekonomi me Hiperinflacion” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky rishikon referencen e perjashtimit te matjes se aktiveve dhe detyrimeve me kosto historike, si ne shenimet e ndertesave, truallit dhe pajisjeve per shembull, me shume se sa te nenkuptoje qe kjo eshte nje liste perfundimtare. Asnje kerkese specifike tranzitore nuk eshte cilesuar pasi ky eshte me teper nje qartesim i referencave sesa nje ndryshim.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IAS 31, “Interesat ne Ndermarrjet e Perbashketa (Joint Ventures)” (Amenduar)**, ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Kjo qarteson qe nese nje ndermarrje e perbashket konsiderohet me vleren reale ne perputhje me IAS 39 (qe eshte e perjashtuar nga kerkesat e IAS 31), vetem kerkesat e IAS 31 do te aplikohen per te sqaruar angazhimet e sipermarresit dhe ndermarrjes se perbashket, si edhe nje permbledhje e informacionit financiar ne lidhje me aktivet, detyrimet, te ardhurat dhe shpenzimet. Aplikimi i hershem eshte i lejuar. Nese do te aplikohet ne periudha me te hershme, nje entitet duhet te aplikojte gjithashtu dhe amendimet e paragrafit 3 te IFRS 7 Instrumentat Financiare: Sqarimet, IAS 28 Investimet ne Pjesemarrje dhe paragrafi 4 i IAS 32 Instrumentat Financiare: Prezantimi ne te njejten kohe.

**IAS 34, “Raportim Financiar i Ndermjetem”, (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim qarteson qe te ardhurat per aksion duhet te paraqiten dhe sqarohen ne raportet financiare te ndermjetem nese nje entitet eshte brenda qellimit te IAS 33.

**IAS 36, “Zhvleresimi i aktiveve”, (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009. Ky amendim sqaron se kur skontimi i flukseve te ardhshme te parase perdoret per te vleresuar “vleren e tregut minus kostot e shitjes”, i njejti shenim kerkohet kur skontimi i flukseve te ardhshme te parase perdoret per te vleresuar “vleren ne perdorim”.

**IAS 38, “Aktive te patrupezuara”, (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009.

-Shpenzimet ne reklama dhe aktivite promovionale njihen si shpenzime kur entiteti ka te drejten ose te perdore te mirat ose te perfitoje sherbimet. Ky standart aplikohet ne menyre retrospektive. Aplikimi ne periudha me te hershme eshte i lejuar.

-Fshin referencat qe jane te rralla, evidence te besueshme per te mbeshtetur nje metode amortizimi per mjetet e qendrueshme te patrupezuara qe kane nje jetegjatesi te percaktuar qe rezulton ne nje vlere me te ulet te amortizimit te akumuluar sesa nen metoden lineare, duke bere keshtu te mundur metoden e njesise se prodhimit. Ky standart aplikohet ne menyre retrospektive. Aplikimi ne periudha me te hershme eshte i lejuar.

-Nje parapagim mund te njihet vetem ne rastin kur pagesa eshte kryer para se te perfitohet e drejta per te perdorur te mirat apo per te perfituar sherbimet.

# Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.a.

## Shenime shoqeruese mbi pasqyrat financiare te konsoliduara per periudhen deri me 31 Dhjetor 2008.

(shuma ne mije Leke, pervecse kur eshte shprehur ndryshe)

---

### 3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(v) Deklaratat e reja (vazhdim)

**IAS 39, “Matja dhe Njohja e Instrumentave Financiare” (Amenduar)**, ne fuqi per periudha vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janar 2009.

-Qarteson qe ndryshimet ne rrethanat qe lidhen me derivativet – veçanerisht derivativet e percaktuar ose ri-percaktuar si instrumenta mbrojtjes (hedging instruments) pas njohjes fillestare – nuk jane riklasifikime. Keshtu, nje derivativ pas njohjes fillestare mundet ose te hiqet ose te perfshihet ne klasifikimin “i tregtueshem”. Ne menyre te ngjashme, kur aktivet financiare riklasifikohen si rezultat i nje kompanie sigurimi qe ndryshon politikat kontabel ne perputhje me paragrafin 45 te IFRS 4 “Kontratat e Sigurimit”, dhe ky eshte nje ndryshim rrethanor dhe jo nje riklasifikim. Per t’u aplikuar ne menyre retrospektive. Aplikimi ne periudha me te hershme eshte i lejuar.

-Heq referencen e ‘segmentit’ ne IAS 39 kur percaktohet nese nje instrument cilesohet si mbrojtjes (hedge) ose jo. Aplikohet ne retrospektive. Aplikimi ne periudha me te hershme eshte i lejuar.

-Kerkon perdorimin e normes efektive te rishikuar te interesit (ne vend te normes efektive fillestare te interesit) kur ri-mat nje instrument borxhi ne mbarim te vleres reale te kontabilitetit te mbrojtjes (hedge accounting). Aplikohet ne retrospektive. Aplikimi ne periudha me te hershme eshte i lejuar.

**IAS 40, “Ndertetat per Investim” (Amenduar)**, ne fuqi per periudhat vjetore ne ose pas 1 Janar 2009.

-Rishikon qellimin (dhe qellimin e IAS 16) qe ndertesa e ndertuar ose zhvilluar per perdorim te ardhshem si ndertese per investim klasifikohet si e tille. Nese nje entitet e ka te pamundur te percaktoje vleren reale te nje ndertese per investim gjate ndertimit, mund te jete ne gjendje ta percaktoje vleren e saj reale ne perfundim te ndertimit, keshtu qe investimi gjate procesit te ndertimit do te matet me kosto deri sa te matet vlere reale qe eshte e mundur ne perfundim te ndertimit. Aplikohet ne menyre prospektive. Aplikimi ne periudha me te hershme eshte i lejuar. Nje entiteti i lejohet te zbatoje amendimet e standartit per pronat e investimit ne proces ndertimi nga cilado date perpara 1 Janarit 2009 duke u siguruar qe vlere reale e ndertesave per investime ne proces ndertimi mund te percaktoheshin ne ato data.

-Rishikon kushtet per nje ndryshim vullnetar ne politikat kontabel per te qene konsistente me IAS 8.

